



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 14157 Prot.  
12

Tiranë, më 21 / 12 2016

REKOMANDIM

Nr. 37 datë 21 / 12 2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Zyra e Komisionerit ka kryer hetim administrativ në ngarkim të kontrolluesit "Pedersen & Partners" sh.p.k. Tiranë, në përfundim të të cilit,

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhërit Nr. 260, datë 07.12.2016 të Komisionerit, për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 12.12.2016 e në vazhdim, grupi i inspektimit filloi procesin e hetimit administrativ pranë kontrolluesit "Pedersen & Partners" sh.p.k. Tiranë, me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, masat për sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit, "Pedersen & Partners" sh.p.k. Tiranë.

Grupi i kontrollit komunikoi me përfaqësuesit e kontrolluesit, mbi detyrimin për zbatim të Urdhrit Nr.260, datë 07.12.2016 të Komisionerit, të cilët ishin njohur me të.

Kontrolluesi "Pedersen & Partners" sh.p.k. Tiranë, sipas licencës nga QKB është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në vitin 2007, me objekt të aktivitetit: konsulencë menaxheriale, kërkim të drejtuesve ekzekutivë që do të punësohen nga klientët të saj si, shoqëri, ndërmarrje, korporata etj.

Kontrolluesi i përfaqësuar nga administratori i saj, në zbatim të kërkesave të Urdhrit Nr.260, datë 07.12.2016 të Komisionerit bashkëpunoi me grupin e kontrollit për finalizimin e këtij urdhri.

**Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:**

1. Kontrolluesi e ka kryer "Njoftimin" në vitin 2009, përsa i përket përpunimit të të dhënave personale, por në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për

- mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar, nuk është deklaruar fakti që, kontrolluesi “Pedersen & Partners” sh.p.k. Tiranë, kryen transferim të të dhënave personale.
2. Kontrolluesi ka rregullore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.
  3. Kontrolluesi aplikon për punëmarrësit “*Deklaratën e Konfidencialitetit*”.
  4. Konstatohet se në portalin ndërkombëtar të kontrolluesit: [www.pedersenandpartners.com](http://www.pedersenandpartners.com), aplikantët informohen mbi përpunimin e të dhënave dhe njihjen me të drejtat e tyre, sipas Direktivës 95/46 të BE-së për mbrojtjen e të dhënave personale.
  5. Kontrolluesi grumbullon dhe ruan të dhënat e subjekteve të të dhënave (aplikantëve) në afat të pacaktuar, duke mos i informuar ata për qëllimin e mëtejshëm të mbajtjes së këtyre të dhënave në afate edhe pasi është përbushur qëllimi për të cilin janë mbledhur këto të dhëna. Në këtë mënyrë, formati që i paraqitet subjektit të të dhënave personale, mbi mekanizmin e pëlqimit nuk është i plotë dhe nuk e informon atë plotësisht.

### **Faktet e mësipërme sipas pikës 5 të konstatimeve, përbëjnë shkelje administrative:**

Të nenit 5, pika 1, gërma “d” dhe nenit 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008, “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar.

### **Në cilësinë e provës materiale, këtij procesverbali i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Njoftimi pranë Zyrës së Komisionerit.
  - Rregullore e brendshme e për mbrojtjen e të dhënave personale.
  - Deklaratë konfidencialiteti.
  - Format i bashkëpunimit të kontrolluesit me klientët e tij (kompanitë të cilat punësojnë punëmarrës të propozuar nga kontrolluesi).
  - Kod etik.
  - Deklaratë pëlqimi.
  - Marrëveshje huamarrje (Loan Agreement).
  - Ekstrakt i Regjistrisë tregtar.
- Printime nga ndërfaqja [www.pedersenandpartners.com](http://www.pedersenandpartners.com).

Zyra e Komisionerit, vlerëson faktin që kontrolluesi ka rregulla të qarta dhe rigorozë për mbrojtjen e të dhënave personale, por në referim të nenit 5, pika 1, gërma “d”, të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008, “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar, i cili shprehet:

*“1. Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:*

*d) në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej”.*

kontrolluesi, ka tejkeluar afatet e ruajtjes së të dhënave personale të subjekteve – aplikantë. Gjithashtu, subjektet e të dhënave nuk janë informuar në lidhje me kohëzgjatjen, që tejkalon qëllimin për të cilin, aplikantët kanë depozituar të dhënat e tyre personale.

Sa më sipër:

Në zbatim të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe në kuadër të gjetjeve të hasura pranë këtij kontrolluesi,

### REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, "Pedersen & Partners" sh.p.k. Tiranë, në përmbushje të neneve 5 dhe 18 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, brenda një periudhe 5 (pesë) ditore nga dalja e këtij akti, të riformulojë formatin e marrjes së pëlqimit nga aplikantët, si dhe të marrë masat për informimin e subjekteve të të dhënave, për afatet e ruajtjes së të dhënave të tyre personale.
2. Kontrolluesi, "Pedersen & Partners" sh.p.k. Tiranë, në përmbushje të nenit 22 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, brenda një periudhe 5 (pesë) ditore nga dalja e këtij akti të realizojë përditësimin e formularit të njoftimit me kushtet aktuale të veprimtarisë së tij, dhe në vazhdimësi, përditësimin për çdo ndryshim të mundshëm të aktivitetit të kontrolluesit në të ardhmen.
3. Kontrolluesi, "Pedersen & Partners" sh.p.k. Tiranë, ka detyrimin të njoftojë Zyrën e Komisionerit, mbi përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ky akt. Plotësimi i këtyre detyrimeve ligjore, mund të jetë objekt hetimi në vazhdimësi.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë. 21 . 12 .2016

